



## THIRRJE PËR APLIKIM NË PROGRAMIN HISTOLAB 2023-2024

HISTOLAB (një projekt i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian) për të promovuar inovacionin në edukimin në histori dhe në përputhje me vlerat dhe standardet e Këshillit të Evropës, synon të bashkëfinancojë, nëpërmjet një procedure për dhënien e grantit në përputhje me Rregulloren 1374 mbi procedurat e dhënies së grantit të Këshillit të Evropës, kërkimin dhe realizimin e një artikulli akademik lidhur me inovacionin në edukimin në histori. Artikuj të tillë mund të lidhen me metodat dhe praktikat e mësimdhënies së historisë në klasë, por mund të kenë të bëjnë gjithashtu me metodat inovative në historinë publike, si në muzetë, vendet përkujtimore ose media. Gjithashtu, eksplorimi i mënyrave inovative të përdorimit të materialeve arkivore në klasë është një fushë interesi potenciale.

Bursa HISTOLAB nuk mund të financojë një projekt të tërë kërkimor, por kërkon të mbështesë kërkuesit përmes një granti financiar në mënyrë që të prodhojnë një artikull të bazuar në kërkime shitesë dhe të dedikuara në lidhje me fushën e tyre të studimit. Përveç një granti financiar, programi ofron përfitime të tjera për përfituesit e HISTOLAB duke ofruar akses në ekspertizën, rrjetin dhe infrastrukturën kërkimore me Partnerët e HISTOLAB (EuroClio, Federata për Arsimin në Evropë (FEDE), Instituti Leibniz për Arsim Media | Georg-Eckert-Institute, House of European History, International Society for History Didactics). Instituti Leibniz për Media Arsimore | Georg-Eckert-Institute ofron të presë studiuesit e HISTOLAB për një vizitë studimore për të përmirësuar kërkimin e tyre mbi artikullin. Ata gjithashtu kanë mundësinë për të eksploruar vizita kërkimore në institucione të tjera duke përdorur grantin financiar.

Programi synon të përforcojë shtrirjen e rezultateve kërkimore të arritura nga studiuesit e HISTOLAB për të dhënë një kontribut të vlefshëm në debatin mbi inovacionin në historinë e edukimit dhe duke botuar një vëllim të redaktuar që përmban artikujt përkatës akademik të shkruar nga studiuesit e HISTOLAB bazuar në hulumtimin e tyre. Bursa HISTOLAB i sjell fituesve zhvillim profesional duke i ftuar ata të prezantojnë punën e tyre gjatë Ditëve Evropiane të Inovacionit në Edukimin Historik, organizuar nga HISTOLAB në vitin 2024, si dhe në aktivitete të tjera të HISTOLAB.

Buxheti i disponueshëm në këtë thirrje është 28.000 Euro. Këshilli i Evropës synon të japë 4 grante me një shumë maksimale prej 7.000 Euro (shtatë mijë Euro) secili. Në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe zgjatjes së kohëzgjatjes fillestare të Projektit, Këshilli i Evropës rezervon të drejtën për të mos dhënë të gjitha fondet në dispozicion dhe/ose për të rishpërndarë fondet e disponueshme në një mënyrë tjetër në varësi të projekt propozimeve të marra dhe nga rezultati i thirrjes për aplikime.

## **MËNYRA E APLIKIMIT:**

Për t'u kualifikuar për bursën, aplikantët duhet:

✓ të jenë të regjistruar ose në një program doktoratë në një universitet ose institucion të ngjashëm që ndjek një projekt kërkimor doktoratë me fokus inovacionin në edukimin e historisë në kuadër të programit të studimit. ( Këto programe mund të përfshijnë studentë nga: historia, edukimi historik, didaktika e historisë, shkencat arsimore, studimet klasike, letërsia, shkenca politike, historia publike, studimet gjinore, sociologjia, historia e artit, studimet muzeale, studimet kulturore, arkeologjia, antropologjia, etnografia, studimet e zonës, etj. Është e rëndësishme që tema e kërkimit e projektit të doktoratës së aplikantit të përputhet me temën "inovacion në edukimin e historisë") ose me profesione që kanë lidhje të ngushtë me historinë (mësues, profesionistë të muzeut, etj.) të cilët mund të shkëputen nga puna gjatë periudhës së zbatimit të grantit në mënyrë që t'i kushtojnë përpjekjet e tyre projektit kërkimor në lidhje me inovacionin në edukimin e historisë. Projekti kërkimor duhet të udhëhiqet nga një studiues me përvojë i lidhur me një institucion universitar ose një institucion i ngjashëm (të paktën me diplomë doktoratë);

✓ të tregojë se projekti i tyre fillestar kërkimor është në një fazë mjaft të avancuar për të qenë në gjendje të sigurojë një bazë për të shkruar artikullin e financuar në kontekstin e bursës HISTOLAB;

✓ gjuha angleze në nivelin B2 sipas Kuadrit Referues Europian për gjuhët;

✓ të paraqesë të paktën një letër rekomandimi, të lëshohet nga mentori zyrtar i projektit kërkimor që formon bazën e njohurive për shkrimin e artikullit mbështetur nga HISTOLAB;

✓ të kenë shtetësinë e të paktën një prej 46 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës;

Çdo aplikim duhet të përmbajë formularin e aplikimit të plotësuar dhe të nënshkruar, duke përfshirë një vlerësim buxheti dhe dokumente të tjera mbështetëse siç janë renditur më poshtë. Këto dokumente, duhet të dorëzohen në formularin elektronik (word dhe/ose PDF) në adresën e mëposhtme të postës elektronike: [histolab@coe.int](mailto:histolab@coe.int), para datës : **E diel, 14 maj 2023, ora 23:59 CET**. Emaillet duhet të përmbajnë referencën e mëposhtme në temë: "Bursë HISTOLAB - Aplikim"

✓ Lista e dokumenteve që duhen dorëzuar:

- Formulari i Aplikimit i plotësuar dhe i nënshkruar (Shtojca I);
- Një buxhet i përkohshëm që përfshin gjithashtu kontributin e përfituesit të grantit në projekt;
- Curriculum Vitae (CV);
- Përshkrimi i detajuar i projektit tuaj kërkimor duke përfshirë aspektin teorik dhe konsideratat metodologjike, rëndësia e tij në lidhje me statusin e literaturës akademike;
- kërkime mbi temën dhe fazën në të cilën ndodhet kërkimi juaj (maksimumi 5 faqe);
- Së paku një letër rekomandimi, ndër të cilat njëra duhet të shkruhet nga mentor i projektit

tuaj kërkimor;

- Letër motivimi që përmban arsyet e interesimit tuaj në HISTOLAB;
- Programi i Fellowship dhe një përshkrim konkret i mënyrave në të cilat HISTOLAB do t'i shtonte vlerë projektit tuaj kërkimor;
- Kopje pasaporte;
- Dëshmi për aftësi në Anglisht, niveli B2; të vërtetohet nëpërmjet: Rezultatet e testit të gjuhës (Set EF:  $\geq 51$  pikë, IELTS  $\geq 5,5$ , TOEIC (R&L):  $\geq 785$  pikë, shkalla angleze e Cambridge  $\geq 160$  pikë, TOEFL iBT  $\geq 72$  pikë, Shkalla Globale e Anglishtes (Pearson)  $\geq 59$ ), ose
- Dëshmi e një programi studimi të nivelit universitar të përfunduar në gjuhën angleze (e vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të diplomimit, si suplementi i diplomës), ose
- Publikime akademike në anglisht të autorizuara nga aplikanti (të dorëzuara si dokumente me tekst të plotë në format pdf);
- Për studentët e doktoraturës: vërtetimi i regjistrimit në universitet (duke treguar edhe vitin e hyrjes në program);
- Për pedagogët e historisë në një "pushim kërkimor": dëshmi e miratimit të pushimit nga punëdhënësi që përfshin një afat kohor në të cilin "pushimi kërkimor" jepet.
- Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në anglisht (si përkthime të vërtetuara, kur është e nevojshme).

Aplikimet që janë të paplota ose të dorëzuara pas afatit të lartpërmendur nuk do të merren parasysh.

Për më shumë informacion ju lutem vizitoni faqen web: <https://www.coe-histolab.eu/activities/histolab-fellowship>